

VENDIM
Nr. 599, datë 18.10.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 884, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2023, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 884, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2023, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ERRU”, bëhen këto ndryshime:

a) Shuma “56 403 200 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e tre mijë e dyqind)” zëvendësohet me “65 093 460 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë).

b) Aneksi nr. 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI NR. 1
PLANI I RISHIKUAR I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2023 (lek)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	42,536,460
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	6,825,730
3	Shërbime e furniturë	15,231,270
4	Investime	500,000
TOTALI		65,093,460